



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 3 mars 2026**

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|---|----|
| Hapja e mbledhjes..... | 1 |
| 1. Projektligji “Për policinë bashkiake”..... | 6 |
| 2. Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të policisë së shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe të punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”..... | 8 |
| 3. Projektvendimi ”Për disa ndryshime në Vendimin nr. 173 datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”, i ndryshuar..... | 11 |
| 4. Projektvendimi “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si destinacione plazhi”..... | 13 |
| 5. Dokumenti për “Procedurat standarde të veprimit për angazhimin e diasporës në nivelin vendor”. | 16 |
| Shtojcë: Të pranishëm | 17 |

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 3 mars 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua në ambientet e Hotel Rogner, salla Antigonea, Tiranë. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga *Z. Ervin Demo, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor/Kryeministria* dhe bashkëkryetari i Këshillit Konsultativ, *Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë*. *Z. Demo*, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektligji “Për policinë bashkiake”

Z. Alban Mësonjësi Drejtor, Ministria e Punëve të Brendshme prezantoi projektligjin “Për policinë bashkiake”, i cili theksoi objektivat e projektligjit si vijon;

a) Reformimi i tejshtirë i policisë bashkiake, si nga ana strukturore ashtu edhe e sistemit të përzgjedhjes së punonjësve, b) Garantimi i zbatimit të unifikuar të legjislationit në fuqi nga policia bashkiake, c) Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe funksioneve në raport me agjencitë e tjera, si për shembull Agjencia për Zhvillimin e Territorit apo me Policinë e Shtetit, d) Ushtrimi i tyre në bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim me ato të tjerat, e) trajtim i vazhdueshëm i punonjësve të policisë bashkiake në të gjithë vendin. Gjithashtu, *z. Mësonjësi* u ndal te efektet e pritshme të projektligjit:

a) Standardizimi i funksioneve të policisë bashkiake në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, b) Koordinim efikas, c) Rekrutim cilësor, d) Rritje e profesionalizmit, e) Rritja e besimit të publikut dhe bashkëpunimit mes komunitetit dhe policisë bashkiake.

Nga vlerësimi i ligjit aktual për policinë bashkiake, kemi evidentuar katër tipologji kryesore të çështjeve që duheshin adresuar me një ligj të ri;

a) Mungesë koordinimi dhe paqartësi e detyrave dhe përgjegjësi të policisë bashkiake në raport me Policinë e Shtetit apo institucione të tjera ligjzbatuese, b) Paqartësi operacionale në zbatimin e detyrave, c) Mungesë efektiviteti, d) Mungesë e politikave për trajtime specifike për punonjësit e policisë bashkiake si dhe të rekrutimeve.

Duhet të ketë një politikë të unifikuar në rang vendi për trajnimin e stafeve të policive bashkiake, me qëllim që të zbatohet në mënyrë të unifikuar legjislationi në fuqi dhe të kemi rekrutime dhe performancë më të mirë të policëve.

Z. Mësonjësi theksoi krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, e cili do të jetë në nivel qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë.

Ndërsa çështje të tjera z. *Mësonjësi* theksoi:

a) Avantazhi i rekrutimeve nëpërmjet proceseve konkurruese më cilësore, b) Trajnim dhe mbështetje logjistike, c) Rritje e forcës reaguese, d) Rritje e profesionalizmit nëpërmjet politikave përkatëse të rekrutimit.

Statusi i policisë bashkiake në nivel vendi do të jetë në varësi të bashkive dhe kryetarëve të bashkive. Pra, nuk cenohet roli i policisë bashkiake si pjesë e njësisë të vetëqeverisjes vendore. Krijimi i Drejtorisë së Përgjithshme nuk cenon në thelb kompetencat, por përmirëson ambientin e funksionimit të standardizuar të policisë bashkiake në rang vendi. Drejtoria e Përgjithshme vjen si një koncept i ri në organizimin strukturor të policisë bashkiake me detyra në rang vendi si:

a) Analizon rendin dhe sigurinë në nivel kombëtar, b) Koordinon policitë bashkiake, c) Harton planet e zhvillimit dhe modernizimit, d) Menaxhon burimet njerëzore, e) Përgatit analiza risku dhe statistika, si dhe bashkëpunon me policinë bashkiake.

Pra, pavarësisht krijimit të një Drejtorie të Përgjithshme në varësi të Ministrit, do të ketë më tepër një rol koordinues për të garantuar zbatimin e unifikuar të praktikave në nivel vendi e cila do hartojë planet e zhvillimit në mënyrë që në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, policitë bashkiake të rrisin performancën e tyre.

Z. *Mësonjësi* theksoi se kryetari i bashkisë vijon të jetë në qendër të funksionimit të policisë bashkiake i cili;

a) Propozon buxhetin, b) Siguron funksionimin, c) Organizon konsultime me komunitetin, d) Merr masa për rritjen e sigurisë dhe rendit, e) Planifikon trajnimin, f) Bashkëpunon me partnerë dhe donatorë, i) Koordinon misione për çështje të sigurisë.

Pra, kryetari i bashkisë do të ketë një rol të rëndësishëm në funksionimin e policisë bashkiake. Projektligji përcakton dhe rolin e prefektit, sikurse edhe në ligjin aktual dhe duke qenë se do të ketë një drejtori të përgjithshme në rang ministrie, si dhe do të ketë një rol edhe ministri përkatës. Një tjetër risi është rekrutimi i stafëve për punonjës të policisë bashkiake në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për rekrutime më të mira, më cilësore, shoqëruar edhe me trajnime të vazhdueshme.

Z. *Demo* theksoi se autonomia vendore mbetet e paprekur ku;

a) Policia bashkiake do të vazhdojë të jetë plotësisht në varësi të kryetarit të bashkisë dhe strukturave vendore, *si dhe*;
b) Nuk do të ketë një Drejtori të Përgjithshme Qendrore që komandon policitë e qyteteve.

Z. *Mësonjësi* theksoi rolin e Ministrisë së Brendshme, ku do të krijohet një strukturë civile (drejtori) që ka si qëllim vetëm unifikimin e standardeve në nivel kombëtar, si dhe do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve përmes Akademisë së Policisë për trajnimin e efektivëve bashkiakë.

Gjithashtu, rekrutimi përmes Portalit Unik për rekrutimet për të garantuar meritokracinë dhe transparencën, ku edhe pse aplikimi bëhet në portal, kontratat dhe procesi i punësimit final mbeten në kompetencë të bashkive.

Aspekt tjetër është koordinimi dhe siguria ku:

- a) Prefekti do të ketë një rol më të fortë koordinues mes qeverisë qendrore dhe bashkive për kontrollin e territorit;
- b) Synimi është bashkërendimi i punëve për një siguri më të lartë në nivel lokal dhe kombëtar.

Drafti për policinë bashkiake është frut i bashkëpunimit me kryetarët e bashkive dhe synon një polici bashkiake më profesionale (me standarde kombëtare), por që mbetet organ totalisht vendor.

Z. Ndreu, Kryetar i bashkisë Lezhë shprehu pozitivitetin për draftin dhe theksoi nevojën për rekrutim me kritere dhe trajnime të detyrueshme, duke vënë në dukje se aktualisht mungojnë standardet (si aftësitë fizike apo komunikimi), si dhe sugjeroi që trajnimet të bëhen nga ekspertë të Ministrisë së Brendshme, por duke shfrytëzuar Akademinë e Pushtetit Vendor. Ndërsa, përsa i përket autonomisë financiare dhe administrative, theksohet se policia bashkiake paguhet nga taksapaguesit vendor (fondet e bashkisë) dhe jo nga buxheti i shtetit (ndryshe nga zjarrfikësit), për këtë arsye, *z. Ndreu* theksoi pasjen e një strukturë plotësisht në dispozicion të pushtetit vendor dhe të mos ketë “përzjerje” nga hallka të tjera administrative.

Z. Ndreu në lidhje me rolin e prefektit nuk përfshihet në menaxhimin e përditshëm të policisë bashkiake. Prefekti ka autoritet mbi policinë bashkiake vetëm në raste emergjencash kombëtare ose lufte, por jo në punën e përditshme rutinë.

Në lidhje me sigurinë *z. Ndreu* sqaroi se policia bashkiake nuk ka për detyrë parësore rendin dhe qetësinë publike, detyrë që i takon Policisë së Shtetit, por mirëfunksionimin e jetës në qytet që lidhen me;

a) Zgjidhjen e konflikteve për pronat, b) Bllokimin e rrugëve apo kanaleve, c) Çështje sektoriale të pushtetit lokal.

Përsa i përket unifikimit të uniformave, propozohet që policia bashkiake të ketë një uniformë dhe shenjë dalluese të unifikuar në të gjithë Shqipërinë, në mënyrë që të mos ndryshojë nga njëra bashki në tjetrën.

Z. Ndreu u shpreh se ministri i pushtetit lokal duhet të jetë përgjegjës për këto, si strukturë ekstra e pushtetit vendor. Nuk ka kuptim që një strukturë e pushtetit vendor, e paguar nga fondet e veta të përgjigjet te Ministria e Brendshme.

Z. Demo argumentoi mbi rolin e prefektit, i cili nuk ka rol drejtues mbi policinë bashkiake. Roli i tij mbetet thjesht koordinues mes strukturave qendrore dhe vendore, por mbivendosja e kompetencave dëmton shërbimin ndaj qytetarit, prandaj ligji i ri synon t'i ndajë prerë këto përgjegjësi.

Z. *Demo* rikujtoi se roli i Ministrit të Brendshëm mbi policinë bashkiake nuk është diçka e re, por ekziston edhe në ligjin aktual, duke lënë të kuptohet se projektligji i ri thjesht po ndjek një praktikë të konsoliduar. Mbështetja për Akademinë e Pushtetit Vendor ku qeveria zotohet të mbulojë 50% të kostove të Akademisë në buxhetin afatmesëm për 3 vitet e ardhshme. Akademia është në hapat e parë, si instrumenti kyç për rritjen e kapaciteteve të policëve bashkiakë, me mundësi për trajnime specifike sipas nevojave të grupeve të ndryshme të bashkive.

Z. *Ndreu* argumentoi se “ruajtja e rendit dhe qetësisë” nuk është dhe nuk mund të jetë detyra parësore e kësaj strukture. Sipas tij, kjo detyrë i takon Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. Përfshirja e policisë bashkiake në çështjet e rendit duhet të konsiderohet vetëm si një mekanizëm shtesë që aktivizohet në situata të jashtëzakonshme kur rendi është i destabilizuar, dhe jo si filozofi pune e përditshme. Z. *Ndreu* kundërshtoi faktin që drafti e lë “bardhë e zi” si detyrë kryesore rendin, duke kërkuar një ndarje më të qartë konceptuale mes policisë që merret me krimin/rendin dhe asaj që merret me shërbimet bashkiake.

Z. *Dalipi* theksoi domosdoshmërinë e reformimit të policisë bashkiake pas ndryshimeve të vitit 2015, duke argumentuar se ky institucion duhet të jetë një instrument në shërbim të komunitetit dhe mbarëvajtjes së territorit nën drejtimin e kryetarit të bashkisë. Ai propozoi që trajnimi i efektivëve të kryhet përmes Akademisë së Qeverisjes Vendore për të garantuar standardet e Bashkimit Evropian dhe sugjeroi një rol më aktiv të Ministrit të Pushtetit Vendor si ndërmjetës për të shmangur përplasjet e kompetencave mes bashkive dhe prefektëve.

Z. *Brahimi*, Drejtor për Financat Vendore, Ministria e Financave theksoi emergjencën për të ndarë qartë kufijtë e kompetencave midis bashkive dhe qeverisë qendrore. Ai kritikoi faktin që shumë ligje po tentojnë t’ua marrin kompetencat bashkive (ricentralizim) dhe përdorin termash si “bashkëpunim” apo “koordinim”, të cilat në praktikë krijojnë vetëm konfuzion dhe përplasje mes institucioneve. Sipas tij, shërbime si policia bashkiake apo zjarrfikësit duhet të mbeten kompetenca ekskluzive e bashkive, ndërsa pushteti qendror duhet të kufizohet vetëm te hartimi i standardeve dhe monitorimi, pa ndërhyrë në vendimmarrjen vendore. Drafti duhet të rishikohet sërish mbi bazën e një analize reale të problemeve që kanë ndodhur deri tani, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm.

Z. *Demo* kërkoi nga pjesëmarrësit që komentet të paraqiten zyrtarisht të lidhura me nene specifike të projektligjit si dhe kërkoi që Ministria e Financave të dërgojë me shkrim se ku duhet ndryshuar narrativa dhe çfarë duhet shtuar konkretisht në tekstin ligjor, në mënyrë që vërejtjet të jenë të trajtueshme nga Këshilli Konsultativ.

Në vijim, z. *Demo* vlerësoi qasjen dhe kjo frymë do të shërbejë si mbështetje për procesin e decentralizimit financiar, i cili është jetik për bashkitë. Z. *Demo* theksoi veçanërisht sistemin AFMIS, duke insistuar që menaxhimi financiar i pushtetit vendor nuk mund të vendoset në izolim vetëm nga Ministria e Financave, por kërkoi përfshirjen e detyrueshme të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe vetë bashkive për një planifikim me vlerë kombëtare.

Z. *Demo* vuri theksin te rëndësia e përfshirjes së të gjithë aktorëve në këtë proces dhe ftoi Ministrinë e Financave të konsiderojë elemente të reja në ligj, siç është roli i Akademisë së

Pushtetit Vendor, si dhe draftet dhe propozimet të qarkullojnë për firma dhe miratim mes ministrave përkatës, në mënyrë që nismat të jenë të koordinuara dhe të sakta për territorin.

Z. Brahimi theksoi se sistemi AMFIS është pothuajse 90% për pushtetin vendor. AFMIS-i nuk është kompetencë dhe as funksion, por është një sistem, një instrument që sa më shumë kontribute teknike të ketë, aq më mirë do të jetë. Absolutisht ai është një instrument, një investim që bëhet nga qeveria shqiptare për menaxhimin e financave publike në nivel vendor dhe qendror.

Z. Demo ndërhyri duke shtuar se pikërisht, prandaj bashkitë duhet të jenë të përfshira.

Znj. Vasilika Vjero, Nënkryetare e bashkisë Tiranë theksoi se bashkia Tiranë ka hartuar propozime konkrete dhe pyetje për nene të caktuara, të cilat do t'i dërgojnë zyrtarisht në rrugë elektronike për të kursyer kohë dhe për të qenë më efikasë në procesin e konsultimit. Në lidhje me procedurat teknike dhe afatet kohore, *znj. Vjero* kërkoi informacion të saktë se kur parashikohet që ky ligj të kalojë për miratim në qeveri, për të kuptuar kohën që kanë në dispozicion për dërgimin e sugjerimeve dhe për të parë më pas një variant të konsoliduar të projektligjit, përpara se ai të marrë formën finale.

Z. Demo qartësoi se bashkitë kanë kohë deri në fund të javës për të përcjellë komentet e tyre zyrtare, si dhe kërkoi që këto sugjerime të mos jenë të përgjithshme, por të lidhen direkt me nene specifike të projektligjit, pasi kjo e bën më të lehtë analizën dhe trajtimin e tyre nga ministrinë përkatëse. Më tej, garantoj se pas mbledhjes së opinionëve, do të punojë ngushtësisht me Ministrinë e Brendshme për të hartuar një draft të ri të konsoliduar dhe përpara se ky draft të kalojë për miratim final në qeveri, do jua ridërgoj përsëri aktorëve të përfshirë për një rishikim të fundit, duke u siguruar që zëri i tyre të jetë dëgjuar.

Z. Edison Shahini, Nënkryetari i bashkisë Gramsh argumentoi mbi vështirësitë në vjeljen e gjobave pas kalimit të shërbimeve në e-Albania. Ai shpjegoi se mekanizmat e vjetër “primitive”si; kushtëzimi i certifikatës me pagesën e gjobës nuk funksionojnë më, duke i lënë bashkitë pa mjete efektive për të mbledhur këto të ardhura. Problemi kryesor që ai identifikoi është kostoja e lartë e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, ku për të përdorur sistemin e tyre të vjeljes, bashkive u kërkohet një komision prej 20-25% të vlerës së gjobës, shifër kjo që ai e konsideron të pafavorshme dhe të rëndë për buxhetet vendore. Gjithashtu, ai përmendi si pengesë mungesën e trajnimit të policëve bashkiakë për të përdorur sistemet teknologjike të transmetimit të të dhënave.

Z. Shahini propozoi që Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ose struktura e re që po krijohet të marrë një rol ekzekutiv në menaxhimin e gjobave, si dhe ligji të parashikojë një mekanizëm të centralizuar dhe të standardizuar që i çliron bashkitë nga varësia prej “agjentëve mbledhës” të shtrenjtë, duke i dhënë policisë bashkiake mjetet dhe trajnimin e duhur për ta kryer këtë proces vetë ose me kosto më të ulët.

Z. Demo i kërkoi nënkryetarit të bashkisë Gramsh që komentet e tij muns ti sjellë dhe me shkrim.

Z. Pervin Gjiguria, Nënkryetari i Bashkisë Himarë argumentoi mbi autonominë e bashkisë dhe shmangien e përplasjeve institucionale. Së pari, ai kërkoi që procesi i rekrutimit të punonjësve të

jetë më i qartë në projektligj, duke insistuar që bashkia të jetë pjesë integrale e vendimmarrjes për stafin e saj dhe të mos lihet mënjanë nga strukturat qendrore.

Së dyti, z. *Gjiguria* shpreh shqetësimin për “dualizmin” e pushtetit, pra rrezikun e mbivendosjes së urdhrave. Ai kërkoi që ligji të kristalizojë hierarkinë dhe kompetencat, në mënyrë që të mos krijohet konfuzion se cilin urdhër duhet të zbatojë administrata, atë që vjen nga Ministri apo atë të Kryetarit të Bashkisë. Sipas tij, kjo qartësi është e domosdoshme për të garantuar funksionimin normal të punës në territor pa ngërçe administrative.

2. Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të policisë së shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe të punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

Z. Aldi Dekavelli, Drejtor, Ministria e Punëve të Brendshme prezantoi projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të policisë së shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe të punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

Projektvendi synon të vërë në zbatim një detyrim ligjor të vjetër (neni 111 i ligjit 108 të vitit 2014) për trajtimin e familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën në detyrë. Pika qendrore është sigurimi i banesës falas për bashkëshortët dhe fëmijët e pastrehë të këtyre punonjësve, krahas ndihmës së menjëhershme financiare dhe pensionit suplementar. Sipas projektvendimit, banesat mund të sigurohen nga disa burime; a) ato të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, b) njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), c) banesat nën administrimin e Korporatës së Investimeve (AIC), apo edhe nga fondi i banesave të konfiskuara të Ministrisë së Brendshme. Një komision i posaçëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme do të verifikojë dokumentacionin e familjarëve dhe do t'ua përcjellë vendimin këtyre institucioneve për sigurimin e shtëpisë.

Z. Dekavelli sqaroi se në rast se asnjë nga këta aktorë nuk ka banesa të disponueshme, Policia e Shtetit ka detyrimin që, përmes buxhetit të saj, të blejë ose të sigurojë banesën për këta familjarë. Përfshirja e bashkive në këtë projektvendim bëhet me qëllim që edhe ato të planifikojnë një pjesë të ndërtimeve të tyre për këtë kategori sociale, si pjesë e një detyrimi ligjor kombëtar.

Z. Mësonjësi sqaroi se përfshirja e bashkive në këtë projektvendim nuk është një detyrim i prerë, por vetëm një nga alternativat e mundshme për sigurimin e banesave falas. Ai thekson se prioriteti i ligjit është garantimi i kësaj të drejte për familjarët e punonjësve të policisë që kanë humbur jetën në detyrë, por kjo nuk do të thotë që barra bie vetëm mbi pushtetin vendor.

Nëse një bashki nuk ka banesa të disponueshme në fondin e saj, qeveria qendrore do të aktivizojë opsionet e tjera si: a) Entin Kombëtar të Banesave, b) blerja e banesave në tregun e lirë nga Policia e Shtetit, c) ose përdorimi i aseteve të tjera nën administrimin e qeverisë. Pra, bashkitë ftohen të kontribuojnë vetëm nëse kanë mundësi reale, ndërkohë që shteti mbetet garantuesi final për realizimin e kësaj të drejte ligjore përmes rrugëve të tjera.

Z. Ndreu argumentoi se këto banesa ekzistojnë në letër dhe në disa raste edhe fizikisht, ku bashkia Lezhë ka gati 5 banesa, por nuk ka një skemë të qartë ligjore se si t'u jepen familjarëve të policëve, si dhe kritikoi faktin që aktet nënligjore nuk përcaktojnë nëse këta njerëz do paguajnë qira, sa do jetë ajo, apo si do të trajtohen nga këshilli bashkiak. Pa këto rregulla, bashkitë e kanë të vështirë t'i fusin njerëzit brenda sepse krijohet një ngërç juridik që mund të zgjasë përgjithmonë.

Gjithashtu, *z. Ndreu* sqaroi se opsioni i Entit të Banesave është i vështirë pasi ata operojnë me kredi, dhe nëse Policia e Shtetit nuk paguan këstet, familjarët nuk mund t'i marrin ato shtëpi. Përfundimi i tij është i prerë: bashkitë janë të gatshme t'i akomodojnë këto familje përmes fondit të tyre social, por qeveria duhet të nxjerrë rregullat se si kjo të kthehet në një proces real pa u bërë një barrë e pamëshueshme për bashkinë.

Z.Demo theksoi se duhet ta shohin nga ana ligjore, por ajo është lënë si alternativë nga pushteti vendor

Znj. Vjero thotë se bashkitë kanë shtëpi (nga fondi 3%), por nuk kanë të drejtë t'i falin ato. Sipas ligjit aktual për strehimin, bashkitë mund të japin banesa me qira sociale ose t'i përdorin si banesa sociale që mbeten pronë e bashkisë, por nuk mund t'ia kalojnë pronësinë një individit pa një bazë ligjore specifike. Problemi është se si do të harmonizohet ky projektvendim i ri me kufizimet që kanë bashkitë. Fondi social prej 3%, që vilet nga çdo ndërtim mbi 2,000 m², është një instrument i fuqishëm, por ai funksionon si pronë publike e bashkisë. Pyetja shtrohet: nëse ligji i Policisë thotë "banesë falas" (që nënkupton kalim pronësie), si mund ta bëjë këtë bashkia kur ligji i saj i strehimit ia ndalon dhurimin e pronës?

Z. Mësonjësi thotë se janë në komunikim me Entin Kombëtar të banesave dhe thekson se ligji ua jep të drejtë familjarëve dhe se ata po ndjekin të gjitha mekanizmat që këtë të drejtë ligjore ta bëjnë efektive.

Znj. Vjero theksoi se bashkia e Tiranës ka si kategori për përfitimin e interesave me kredi të buta dhe vetëm javën e kaluar kanë kaluar 1500 kuota, por nuk e shikon në ligj se si pushteti vendor mund ti bëjë pronarë të këtyre banesave dhe ngre pyetje nëse ky ligj mbivendoset me atë të sistemit social

Z. Ndreu theksoi se duhet të rregullohet baza ligjore sepse nuk e kanë të rregulluar me ligj se si do ti japin banesat. *Z. Demo* argumentoi se duhet sqaruar mekanizmi nëse njësitë e vetëqeverisjes vendore që e kanë mundësi për të akomoduar këtë kërkesë dhe duhet sqaruar procedura që bashkitë të kenë të drejtë të kalojnë pronësinë.

3. Projektvendimi "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 173 datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024", i ndryshuar

Z. Albin Gega, Drejtor, Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit prezantoi projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 173

datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”, i ndryshuar, i cili sqaroi a) objektivat dhe arritjet kryesore.

Garancia Rinore synon që çdo i ri (15-29 vjeç) të marrë një ofertë punësimi, arsimit ose trajnimit brenda 4 muajve. Pilotimi në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë ka qenë mjaft i suksesshëm, nga synimi fillestar prej 500 personash, janë arritur 2,250 të rinj me oferta konkrete. Shifrat tregojnë një balancë gjinore pozitive (55% vajza dhe 45% djem) dhe një rënie të numrit të të rinjve që nuk janë as në punë e as në shkollë (NEET).

b)Përfshirja Sociale dhe Kategoritë Specifike

Një pikë e fortë e raportit është suksesi me grupet e marginalizuara, ku 76% e të regjistruarve kanë marrë një ofertë pozitive. Ndarja specifike sipas kategorive deri në fund të vitit 2025 është si vijon:

- Ndihmë ekonomike: 232 persona
- Romë dhe Egjiptianë: 153 persona
- Aftësi të kufizuara: 83 persona
- Migrantë të kthyer: 30 persona
- Viktima të trafikimit/dhunës: 17 persona
- Pagesë papunësie: 13 persona

c)Reforma në Arsim dhe Sistemin “Dual”

Është jetësuar modeli ku nxënësi mëson profesionin drejtpërdrejt në biznes (3 ditë punë me pagesë dhe 2 ditë shkollë). Po ashtu, sistemi 2+1+1 në shkollat profesionale lejon certifikimin e nxënësve për tregun e punës që në vitin e tretë. Oferta është pasuruar me programe të reja si energjia e rinovueshme dhe menaxhimi i strukturave akomoduese (niveli 5 i kualifikimit).

d)Financimi dhe Plani 2026-2028

Me një fond prej 63.5 milionë euro (ku 50 mln janë grant nga BE), Shqipëria po përgatitet për shtrirjen kombëtare të këtij plani gjatë viteve 2026-2028. Janë digjitalizuar proceset përmes sistemit të AKPA-s dhe është forcuar bashkëpunimi me 61 bashkitë e vendit për të gjurmuar dhe këshilluar të rinjtë në çdo cep të territorit.

Z. *Ndreu* shtron pyetjen nëse ka të re plani i zbatimit të garancisë rinore.

Z. *Gega* theksoi se ndryshimi kryesor qëndron në trefishimin e mundësive dhe financimeve. Programi nuk do të kufizohet më vetëm në tre qarqet fillestare, por do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Plani i ri mbështetet në një proces të gjerë konsultimi me mbi 50 institucione dhe 40 këshilla rinorë vendorë, duke përfshirë 17 reforma dhe 28 masa konkrete.

e)Shërbimi "One-Stop-Shop" te Piramida

Një risi e rëndësishme është hapja e një zyre qendrore te Piramida në Tiranë. Kjo zyrë do të shërbejë si një pikë e vetme kontakti (“one-stop-shop”), ku çdo i ri mund të marrë ofertën e plotë (punësim, trajnim ose arsim) pa pasur nevojë të drejtohet në institucione të tjera.

Reformat dhe Inovacionet e Reja

- Fuqizimi i AKPA-s, a) amendimi i ligjit për nxitjen e punësimit dhe emërimi i koordinatorëve të dedikuar posaçërisht për Garancinë Rinore;
- Programet Sociale, b) pilotimi i shërbimeve “after-school” (pas shkollës) në 30 shkolla publike të Tiranës dhe programe të reja për integrimin social;
- Orientimi në Karrierë, c) krijimi i një kuadri kombëtar për orientimin profesional dhe forcimi i kapaciteteve të këshilluesve të punësimit përmes trajnimeve të shkurtra.

Diversifikimi i Ofertës

Vazhdon fokusimi te niveli i pestë i kualifikimeve (kurse profesionale post-sekondare) dhe diversifikimi i shërbimeve për t'iu përshtatur nevojave të tregut, duke siguruar që asnjë i ri të mos mbetet jashtë sistemit të mbrojtjes dhe zhvillimit profesional.

Z. *Demo* shtroi pyetjen nëse programi do të zgjerohet apo do të vazhdojë të zbatohet përsëri vetëm në tre qarqe.

Z. *Gega* theksoi se risia është që me fillimin e kalimit të fondit të akorduar nga Bashkimi Evropian, do të kemi mundësinë përgjatë 2026-ës të kalojmë në të gjithë qarqet.

Znj. *Vjero* kërkoi rishikimin e menjëhershëm të një mase të alokuar për Bashkinë e Tiranës, duke argumentuar se programi për mbështetjen e detyrave të shtëpisë i takon Ministrisë së Arsimit. Bashkia Tiranë parashikon të shtojë aty shërbimin e ushqimit për ata fëmijë të cilët do të rrinë, dhe bëhet fjalë për fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e pestë, kështu që, mendon që ndoshta nuk ka nevojë për shumë diskutime në këtë tryezë, por e mira do të ishte që ta rishikojnë pak këtë masë sepse mund të ketë ndonjë gabim para se të miratohet. Znj. *Vjero* theksoi se në këtë strategji duhet të flitet me më shumë shifra konkrete dhe me aktivitet konkret duke qenë se si njësi vendore kanë zyrat e tyre të punësimit dhe këshillimit të karrierës. Znj. *Vjero* ngriti pyetjen sesi këto zyra do të integrohen me strukturat në nivel qendror, duke qenë se u fol për një *one-stop-shop-t*. *One-stop-shop-i* do të jetë në nivel qendror dhe do të mbulojë dhe funksionet vendore, apo ne do të vijojmë të funksionojmë më vete pa sisteme të unifikuara dhe shkëmbim informacioni, që sigurisht nuk ndërvepron me njëri-tjetrin.

Z. *Gega* theksoi se nuk ka buxhet në të cilin bashkitë do të jenë pjesëmarrëse, ku rreth 80% është grant dhe 20% është në nivel të buxhetit të shtetit.

Znj. *Vjero* theksoi se mirë është ta rishohim përpara se ta miratojmë edhe një herë.

Z. *Gega* sqaroi se përsa i përket pyetjes së dytë, padyshim është detyrim, urdhër i Kryeministrit dhe thotë shumë qartë detyrimin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit të të gjitha institucioneve. Bashkia e Tiranës është e listuar në këtë urdhër dhe duhet të marrë pjesë nga një grup teknik i cili

udhëhiqet nga Zëvendësministrja e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe aty koordinohet çdo veprim, si dhe padyshim, jo për institucionet dhe për bashkitë që janë të mirëpritura dhe duhet të jenë patjetër aktorë në këtë proces, por madje edhe për organizatat në nivel vendor, këshillat bashkiakë dhe organizatat rinore nëpër bashki padyshim duhet të jenë pjesëmarrëse në proces.

Z. *Demo* theksoi se duhet bërë një verifikim më i detajuar.

4. Projektvendimi “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si destinacione plazhi”

Z. *Elton Orozi*, Drejtor, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit prezantoi projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si destinacione plazhi”

Akti buron nga ligji i posaçëm 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Ky akt synon të rregullojë një boshllëk procedural që vjen nga parashikimi për mbështetjen me vënien në dispozicion të hapësirës së plazhit për investitorët strategjikë, sipas një kontrate strategjike, pas shqyrtimit të tyre nga Komiteti i Investimeve Strategjike. Përgjatë periudhës 2015-2025, Komiteti i Investimeve Strategjike ka miratuar një sërë vendimesh nga të cilat është konkretizuar me procedurë të veçantë për rreth 2/3 e tyre, e cila kalonte përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave. Kjo kërkonte kohë, vendimmarrje të gjatë dhe shpeshherë konfuzion për investitorët strategjikë. Ndërmarrja e ndryshimeve në fillim të janarit të vitit 2025 për ligjin e investimeve strategjike synonte pikërisht lehtësimin e këtij procesi dhe përcaktonte institucionet përgjegjëse. Synimi i projektaktit është disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit dhe përdoruesit të gëzojnë statusin “investitor strategjik” sipas vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS). Ky është një projektvendim i thjeshtë me dy nene në thelb dhe ajo që ka rëndësi dhe kërkon edhe vëmendje është drafti i marrëveshjes bashkëngjitur projektaktit, e cila përcakton palët të cilat do të jenë Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe subjekti investitor. Tashmë do të kemi një afat maksimal kontrate të caktuar, që zakonisht ka qenë diskutim përgjatë proceseve në të kaluarën. Sipërfaqet e stacioneve të plazhit do të jenë në përputhje me vendimmarrjen e KIS-it, pra ato vendime të cilat kanë boshllëk dhe nuk kanë të parashikuar sipërfaqen do t'i hyjnë një procesi vlerësues.

Tarifat do të jenë në përputhje me vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, por risi e aktit është indeksimi i tij me inflacionin vjetor, gjë që s'ka qenë në rastet e mëparshme. Gjithashtu, drafti i marrëveshjes parashikon edhe disa standarde të përcaktuara që lidhen me elementët e sigurisë në stacionet e plazhit dhe normalisht i referohet në tërësi edhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi apo legjislacionit të përgjithshëm për stacionet e plazhit. Kjo marrëveshje parashikon edhe penalitete për mospërbushje të detyrimeve të cilat janë përcaktuar qartë në draftin e paraqitur.

Z. *Ndreu* ndau shqetësimin se në akt nuk përfshihet pushteti vendor. Megjithëse bëhet fjalë për investitorë strategjikë, normal që kanë një status ndryshe. Referenca e këshillit bashkiak duhet

sqaruar, ndërkohë tarifën e nxjerr Ministria e Financave. Pagesat i bën sipas tarifës që nxjerr Ministria e Financave në referencë të vendimit të Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak ka referenca që i janë dhënë këtë vit për stacionet e plazhit. Meqenëse, citohet "stacionet e plazhit", atëherë kur vjen puna te stacionet e plazhit, investitorët strategjikë, në Vkm-në që do bëhet, duhet të shmangen. Të përmenden si rast që nuk hyjnë në kontratat që bëjnë me Agjencisë së Bregdetit, subjektit dhe bashkisë. Koncepti i stacionit të plazhit është një hapësirë publike që është në dispozicion të pushtetit vendor, por që shkon te investitori strategjik. Atëherë Vkm-ja që del nga qeveria për stacionet e plazhit ka një përplasje që duhet sqaruar.

Prandaj, edhe mospërmendja e pushtetit vendor, të paktën në rolin mbikëqyrës të stacioneve të plazhit, sidomos, ose në përgjithësi, sepse është e pamundur që Agjencia e Bregdetit të ketë kapacitetet njerëzore në të gjithë vijën bregdetare ta mbikëqyrë zbatimin e disa kërkesave që janë normale, që janë shkruajtur aty dhe shumë mirë që janë vënë. Por, t'i mbikëqyrin vetëm ata, unë mendoj që pushteti vendor duhet të ketë rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të kriterëve. Se nëse në një investitor strategjik aty po supozojmë se nuk i bën, dhe një tjetër aty i bën, me të cilin ne kemi kontratë, atëherë më duket se ne dalim jashtë loje si pushtet vendor. Agjencia e Bregdetit, për mendimin tim, nuk e monitoron dot gjithë bregdetin, gjithë stacionet e plazhit, gjithë problematikën. Agjencia e Bregdetit nuk ka vetëm këta investitorë strategjikë, por ka edhe me pushtetin lokal të gjithë stacionet e plazhit që vijnë për shkak të kontratave me të tjerë.

Z. Orozi dakordësoi me shqetësimet e kryetarit *Z. Ndreu* duke sqaruar se akti synon të përmirësojë të gjithë procedurën aktuale të ndjekur apo të gjithë bazën ligjore e cila mundëson vënien në dispozicion të stacioneve të plazhit për subjektet në përgjithësi dhe për këta subjekte që kanë një status të veçantë. Prandaj procedura e vënies në dispozicion është përcaktuar në akt. Ndërkohë që asnjë nga të drejtat apo detyrimet që pushteti vendor ka për t'u shtuar për kontrollin apo zbatimin në territor të kushteve të bashkëlidhura nga Vkm-ja standarde për stacionet e plazhit do të vazhdojë. Pra, nuk përjashtohet në këtë rast pushteti vendor nga ato kompetenca. Pra, të njëjtat kompetenca që ka gëzuar ka dhe tani dhe do të vazhdojë t'i gëzojë. Këtu lidhet thjesht me procesin e vënies në dispozicion dhe mënyrës se si do t'i vihet kësaj kategorie të subjekteve.

Z. Ndreu theksoi se problemi i stacioneve të plazhit në fakt është rasti më tipik në botë ku ministria merret me stacionet e plazhit. Ska sistem në botë që e ka këtë. Është i vetmi shtet në botë që e aplikon nëpërmjet Agjencisë së Bregdetit dhe Ministrisë së Turizmit. Megjithatë, nuk është problem se ne e kemi harmonizuar këtë, por akti e ka fshirë fare pushtetin vendor nga përfshirja. S'ka lidhje referenca e tarifës së pushtetit vendor me pjesën e bregut, se ne nuk kemi një të tillë dhe nuk kemi akses fare. Pra, stacioni i plazhit është tjetër gjë dhe një investitor strategjik ka diçka ndryshe. Megjithatë, në qoftë se ai i nënshtrohet të gjitha tarifave që vendosen në këshill bashkiak, është problem tjetër pastaj që do parë. Por, mund ta shtoni një paragraf që në zbatim të Vkm-së për stacionet e plazhit, pushteti vendor ushtron gjithashtu kompetenca në mbikëqyrjen e standardeve 1, 2, 3, 5, etj. Mund ta shtoni një gjë që vjen në harmoni me një Vkm e stacioneve të plazhit.

Z. Gjokuria, Nënkryetari i bashkisë Himarë argumentoi mbi nenin 4, pika 1 dhe 2, ku duhet qartësuar se kush do të jetë çmimi. Nuk është e qartë se çfarë ndodh nëse subjekti nuk paguan brenda afatit prej 30 ditëve. Gjithashtu, neni 8, zgjidhja e marrëveshjeve, pika c, dhe neni 9,

njoftimi për zgjidhjen e marrëveshjes, pika 2, bien ndesh me njëri-tjetrin. Pasi në nenin 9, pika 2 citohet që në rast se plotësimi i afatit të përcaktuar mësipër konstaton se përdoruesi nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimit financiar, dhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë marrëveshje me përdoruesin për shkak të mospërmbushjes, e të tjerë, e të tjerë. Kurse në nenin 8, pika 2, shkronja c, kur me vendim të formës së prerë të Gjykatës Administrative është vendosur zgjidhja e marrëveshjes sepse përdoruesi nuk ka përmbushur detyrimin e tij sipas parashikimeve të nenit 4.2 të marrëveshjes. Pra kemi një paqartësi se kush prevalon. Dhe duke qenë se bashkia Himarë, mirë apo keq, ka një pjesë të mirë të këtij brezi të investitorëve strategjikë, besoj se ndikon drejtpërdrejt në financat vendore. Gjithashtu, besoj se në raportin e plazheve publik-privat do të jetë i njëjti raport që vendoset nga VKkm-ja për të gjithë plazhet, apo do të ketë një trajtim tjetër për sa i përket qasjes së komunitetit në plazh.

Z. Orozi argumentoi se duke u nisur nga pjesa e fundit që ju parashtruat, normalisht parashikimet që ka akti kuadër, i cili rregullon në tërësi stacionet e plazhit, prevalojnë mbi të gjitha rregullat e tjera të parashikuara. Ndërkohë, nëse ka kontradikta, do të duhet t'i rishohim për t'i definuar dhe për të shmangur çdo gjë të tillë. Por, aty parashikohen dy raste kur bëhet zgjidhja e menjëhershme apo një zgjidhje që vjen nga një gjykatë.

Z. Gjiguria shtroi pyetjen mbi penaltetet, se kush do t'i marrë, Ministria e Turizmit në këtë rast, që lidhen me stacionet e plazhit e të tjerë e të tjerë, që janë në ligjin për turizmin, që është i miratuar para dy vitesh. Pra këto penaltete 100% shkojnë në buxhetin e shtetit, si përfitues, nuk i shkojnë pushtetit vendor. Ndërkohë për mospagimin në afat të tarifës, penaltetet mos duhet të citohen, sepse në qoftë se nuk e paguajnë në afat tarifën, sigurisht që administrata patjetër që do sjellë një njoftim të parë, pastaj fillon me një gjobë për pagesë të vonuar, me interesin e munguar, me masa shtrënguese e të tjera.

5. Prezantim i dokumentit mbi “Procedurat standarde të veprimit për angazhimin e diasporës në nivelin vendor”

Znj. *Keti Luarasi, Ekspert, Projekti “Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), prezantoi dokumentin mbi “Procedurat standarde të veprimit për angazhimin e diasporës në nivelin vendor”* theksoi se me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar, së bashku me IOM-in si partner, ndihmon për rritjen e kapaciteteve lokale për migracionin dhe diasporën. Aktualisht, procedura e standardeve të veprimit ka për qëllim krijimin dhe standardizimin, unifikimin e këtyre procedurave se si duhet të veprojnë konkretisht të gjitha bashkitë e vendit për të maksimizuar atë resurs që ne kemi nga diaspora. Ne të gjithë e dimë se sa e rëndësishme është, dhe duke parë edhe mbështetjen e jashtëzakonshme dhe futjen në një prioritet të shfrytëzimit të diasporës edhe nga qeverisja qendrore, kjo shkon shumë mirë në linjë me zhvillimin që ne duhet të japim dhe fokusin që secila prej bashkive tona do të duhet të japë menaxhimit të migracionit dhe diasporës.

Për sa i përket objektivit që ka kjo procedurë standarde veprimi, është që të vendosen të gjitha bashkitë në të njëjtën formë, të dinë të ecin me të gjitha procedurat që do të duhet të kryejnë. Normalisht, jo të gjitha bashkitë kanë një strukturë të përcaktuar për implementimin e funksioneve që janë të përcaktuara me ligj dhe që janë të vendosura në ligjin nr. 139/2015 të qeverisjes vendore.

Kuadri rregullator mbi të cilin bazohet procedura standarde e veprimit është, pa diskutim, ligji 139, dsi dhe një pjesë e mirë e të gjitha strategjive që janë të vendosura:

- a) Strategjia për Integrimin Evropian (Strategjia e Zhvillimit për Integrimin Evropian);
- b) Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030;
- c) Strategjia Kombëtare për Diasporën 2021–2025.

Kjo e fundit ka qenë një strategji e bërë në bashkëpunim me IOM-in, por në të njëjtën kohë, aktualisht organizata IOM ka marrë përsipër mbështetjen e qeverisë shqiptare edhe për krijimin e strategjisë së re të diasporës, që do të jetë për periudhën 2026–2030.

Të gjitha këto janë baza ligjore mbi të cilat procedurat standarde të veprimit duhet të organizohen në pushtetin vendor. Kjo është akoma më në linjë të drejtë edhe me pjesën e kuadrit ndërkombëtar, ku qeveria shqiptare ka miratuar Paktin Global për Migracionin dhe Diasporën, objektivi 19 i të cilit pasqyron mjaft mirë zhvillimin e qëndrueshëm dhe inkurajon ndërtimin e politikave institucionale që lehtësojnë angazhimin e diasporës, duke përfshirë këtu të gjithë bazën, kornizat ligjore dhe funksionet që janë duke u mbështetur në nivel lokal.

Znj. Luarasi përmendi funksionet konkrete që secila nga bashkitë tona do të duhet të zbatojë.

- a) Ngritja e strukturave vendore për diasporën dhe migracionin. Aktualisht, në nivel kombëtar, ku të paktën 46 bashki e kanë të krijuar strukturën e migracionit dhe diasporës, ndërkohë që pjesa tjetër e kanë të deleguar si kompetencë tek një nga sektorët e tjerë të institucionit;
- b) Ajo çfarë është e përcaktuar në ligjin 139, ekzaktësisht në nenin 29 të tij, është komunikimi dhe informimi i diasporës;
- c) Konsultimi dhe referimi i rasteve;
- d) Bashkëpunimi ndër-institucional dhe ndërbashkiak;
- e) Menaxhimi i të dhënave dhe raportimi për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

Në fakt, të gjitha këto janë të përkthyer ekzaktësisht në procedurën, në draftin e procedurës standarde të veprimit të cilën ne jua kemi propozuar. Ajo është e krijuar në formën e një metodologjie shumë të qartë:

- a) Kush duhet të merret brenda institucionit të bashkisë për të ndjekur ecurinë dhe zbatimin e këtyre funksioneve;
- b) Kur duhet të krijohet subjekti përgjegjës për veprimin dhe ndërmarrjen e masave;
- c) Çfarë është masa konkrete që duhet ndërmarrë (çfarë duhet të bëjë konkretisht bashkia) dhe si duhet të zbatohet masa.

Kjo është metodologjia e përcaktuar në secilën nga detyrat që janë vendosur në procedurën standarde të veprimit. Aktualisht, metodologjia e përkthyer në strukturimin e procedurës standarde të veprimit është e tillë që ju janë vendosur në mënyrë të detajuar dhe në një gjuhë shumë të thjeshtë se cilat janë detyrat konkrete që duhet të bëjnë strukturat tuaja për të maksimizuar thithjen dhe angazhimin e diasporës në nivel lokal, duke krijuar që në momentin e pare pra, ka qenë detyra juaj, dhe vazhdon të jetë detyra juaj, për krijimin e faqeve zyrtare. Këto të përcaktuara në faqen zyrtare të bashkisë, të cilat bëjnë të mundur pasqyrimin se ku dhe çfarë mund të marrë diaspora në

momentin që do të angazhohet për të kontribuar në bashkinë tuaj specifike. Detyrat e tjera janë pjesa e informacioneve, fushatave të ndërgjegjësimit, konsultimeve që mund të bëhen me qytetarët, mbajtja e një regjistri të përcaktuar për evidentimin e të gjithë diasporës e cila funksionon për secilën nga bashkitë tuaja, dhe padiskutim pjesa e përmirësimit se si mund të maksimizohet shfrytëzimi i diasporës, qoftë në kapacitete apo qoftë edhe me investime dhe kjo shkon shumë në linjë edhe me, për shembull, paketën e maleve, e cila mund të jetë një nga elementët më të rëndësishëm që ka aktualisht qeveria për të maksimizuar edhe pjesën e thithjes së investimeve nga diaspora. Procedurat kryesore të cilat janë të vendosura dhe janë të krijuara hap pas hapi japin veprimin, hapat konkretë se si duhet të punojë secili nga punonjësit e deleguar me kompetencën e diasporës dhe migracionit brenda strukturave tuaja, dhe këto janë të gjitha procedurat të cilat në fund masin edhe impaktin që ato kanë realisht në komunitetin e diasporës. Aktualisht janë të vendosura të shpjeguara kanalet e informimit, pjesa e aksesueshmërisë së informacionit, pra ku duhet diaspora konkretisht të shikojë online për të gjitha nevojat që keni juve për pjesën e investimeve, ose ku duhet të futet ai për të bashkëpunuar apo për të marrë një shtetësi të dytë. Domethënë, ka shumë për të marrë shtetësi shqiptare për shembull, ne kemi brezin e dytë të diasporës të cilët mund të mos e kenë fare shtetësinë shqiptare, po ndërkohë mund të jenë të interesuar pra, ju online do të duhet të keni informacionin se ku mund të drejtohet personi që është nga diaspora për t'u angazhuar me bashkinë konkrete. Fushatat e ndërgjegjësimit, materialet informuese, vlerësimin e nevojave dhe forcimin e kapaciteteve, ku mbi këtë kuadër *znj. Luarasi* theksoi që aktualisht IOM-i është duke mbështetur shtatë bashki pilot, që janë bashkia e Shkodrës, Dibërës, Kukësit, Kamzës, bashkinë e Tiranës, Sarandës dhe Vlorës, duke asistuar qoftë me shkrimin konkretisht të këtyre procedurave standarde të veprimit qoftë për migracionin, qoftë për diasporën, por në të njëjtën kohë edhe duke i ardhur në ndihmë për aktivizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve konkrete si për thithjen e diasporës, ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve që duhet t'u japin konkretisht të gjithë personave të rinj që vijnë në qytet, që janë emigrantët, qoftë ata të brendshëm apo të jashtëm.

Bashkëpunimi ndërinstytucional është një element shumë i rëndësishëm i cili përcaktohet me elementë shumë të thjeshtë dhe që do t'u vijë në ndihmë punonjësve tuaj për të kuptuar se sa e mirë është pjesa e bashkëpunimit me ministrinë e linjës, për shembull me Ministrinë e Investimeve të Huaja apo Ministrinë e Investimeve për të gjithë këtë pjesë të diasporës që dëshiron të vijë dhe të kontribuojë në vendin tonë, apo me institucione që mund të jenë ndërbashkiake, sidomos për bashkitë që janë në kufi dhe që nuk kanë një strukturë të ngritur edhe funksionale sepse janë bashki shumë të vogla për të punuar me migracionin dhe diasporën.

Konsultimet fillestare dhe menaxhimi i të dhënave dhe raportimi, monitorimi dhe përmirësimi janë procedura që janë të shtjelluara në procedurën standarde të veprimit, janë shumë të thjeshta për t'u aplikuar dhe për t'u zbatuar nga secila prej bashkive tona. Dhe ne këtu kemi përmendur edhe një paketë minimale të shërbimeve të cilat, qofshin edhe bashki shumë të vogla të cilat këtë funksion e kanë të deleguar tek sektori i Integritimit European apo i menaxhimit të projekteve (sepse varion gama në formë shumë të madhe), se cilat janë ato elementet më të rëndësishme që të fillohet dhe të punohet për zbatimin e këtij ligji dhe kësaj detyre funksionale që i është kaluar bashkive.

Rolet i kemi të përcaktuara sipas modeleve që duhet dhe metodologjive ndërkombëtare, dhe është shumë mirë e përcaktuar në procedurën standarde të veprimit sepse në momentin që ne përcaktojmë rolet e brendshme që ka qoftë kryetari i bashkisë apo secili nga specialistët brenda

institucionit, rritet edhe pjesa e përgjegjshmërisë edhe e angazhimit që duhet të ketë secila nga strukturat e bashkive për të punuar qoftë me migracionin apo me diasporën. Kështu që u kemi dhënë edhe modele të ndarjes së përgjegjësisë dhe të funksionimit konkret të kësaj procedure.

Gjithashtu, kemi vendosur në procedurë edhe disa indikatorë me të cilët ju mund të masni ecurinë e implementimit të këtij funksioni në nivelin e qeverisjes vendore. Mua më vjen mirë që aktualisht AMVV-ja (Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore) së bashku me ministrinë e ka të përcaktuar tashmë dy indikatorë në vlerësimin e performancës, që janë planet e veprimit për migracionin dhe diasporën dhe është shumë mirë që përveç bashkive me të cilat ne jemi duke punuar konkretisht për pjesën e suportit për krijimin e planeve të veprimit për migracionin dhe diasporën, të ketë mundësi që të gjitha bashkitë e tjera të ecin krah për krah. Shumë mirë që i kemi vendosur edhe këto si indikatorë performance.

Një element tjetër është që qeveria shqiptare së bashku me donatorë të ndryshëm, qoftë ambasadat si në rastin konkret Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar apo organizata të tilla si IOM, janë duke punuar jo vetëm për rritjen e kapaciteteve në nivel qendror, por edhe për nivelin vendor. IOM-i shumë shpejt do të lançojmë një thirrje për të promovuar dhe për të çertifikuar ato aktivitete që secila prej bashkive tuaja bën me diasporën. Do të jetë në formën e një konkursi; secila nga bashkitë tuaja do të jetë e lirë për të marrë pjesë për të treguar dhe për të ndarë eksperiencat me bashkitë e tjera. Do të jenë disa çmime simbolike që do të vendosen për bashki konkrete, por mbi të gjitha është shumë e rëndësishme rritja e kapacitetit që do të ketë niveli vendor dhe propozojmë që brenda buxhetit që kemi në dispozicion për vitin që vjen, të mbështesim edhe Akademinë e Pushtetit Vendor me modulet e trajnimit specifikisht për migracionin dhe diasporën. Kështu që këto janë elementet më të rëndësishme që ne kishim për të prezantuar. Janë aktualisht trajnuar të paktën 46 bashki mbi procedurën standarde të veprimit për migracionin dhe për këtë procedurë standarde të veprimit për diasporën.

Znj. Luarasi nënvizoi se si drejtpërdrejt do të duhet të punojnë me ata që rikthehen nga emigracioni, që janë emigrantët e rikthyer, për të kristalizuar se si do të duhet të funksionojnë secili nga grupet dhe sektorët, njësitë e migracionit dhe diasporës për t'u ofruar shërbimet, qoftë për arsimin, strehimin, shërbimet sociale, të gjithë atyre të rikthyerve në qytetin e tyre. Shumë faleminderit.

Znj. Vjero drejtoi pyetjen se çfarë duhet të miratojë këshilli në këtë proces.

Znj Luarasi sqaroi që secila nga bashkitë normalisht do të duhet ta përshtasë me procedurat standarde të veprimit. Pra, janë të paktën 10 procedura, hapa konkretë se si duhet të punojnë bashkitë për të arritur implementimin e legjislacionit që është tashmë funksional për bashkitë. Bashkitë aktualisht duhet ta përthejnë dhe ta përshtasin këtë procedurë me strukturat e tyre funksionale, ta kalojnë me një urdhër kryetari dhe më pas ajo merr vlerën e aktit normativ dhe është automatikisht e zbatueshme. IOM-i momentalisht është duke punuar me Shoqatën Kombëtare të Bashkive duke i dhënë atyre një asistencë konkrete për ndjekjen dhe krijimin e forumit teknik për migracionin dhe diasporën. Aktualisht është krijuar forumi teknik me të gjitha bashkitë dhe është marrë edhe trajnimi i parë, kështu që personat që janë teknikë të secilës bashki do të punojnë konkretisht. E rëndësishme është që ju të jepni "OK"-in si kryetarë bashkish që edhe urdhrin që ata ta zbatojnë këtë lloj procedure

Z. Dalipi theksoi se është në praktikën e Këshillit Konsultativ që herë pas here kush nga organizatat ndërkombëtare kërkon të prezantojë projekte që lidhen me qeverisjen vendore, i drejtohen këtij këshilli dhe në këtë rast ishte IOM-i që herë pas here ka prezantime të tilla.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje të zhvilluar me datën 3 mars 2026

| Anëtarët e Këshillit Konsultativ | | | |
|---|---------------------|-----------------------|---|
| Nr | Emri Mbiemri | Pozicioni | Institucioni/Organizata |
| 1 | Ervin Demo | Ministër | Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor/Kryeministria |
| 2 | Aldrin Dalipi | Kryetar | SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë |
| 3 | Arian Jaupllari | Zv/ministër | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 4 | Fran Brahimi | Drejtor | Ministria e Financave |
| 5 | Elona Hoxha | Zv/ministër | Ministria e Drejtësisë |
| 6 | Hantin Bonati | Zv/ministër | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| 7 | Pjerin Ndreu | Kryetar/Bashkia Lezhë | Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë |
| 8 | Ermira Urupi | SHKQSH, Kryetar | Këshilli i Qarkut Elbasan |
| 9 | Ervis Moçka | SHKQSH, Kryetar | Këshilli i Qarkut Vlorë |

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për aktet e diskutuara në mbledhjen e Këshillit Konsultativ datë 3 mars 2026

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/3-mars-2026/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.